



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. 2-D/DPK
 Nr. i faq. _____
 Broj stranica 02
 Nr. pages _____

Nr Prot. _____
 Br. Prot. 01-847/14
 Prot No. _____
 Data _____
 Datum 12.03.2014
 Date _____

PRISTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 10.03.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2426/13 dhe 03-2427/13 për z. Halim Sadiku – Anëtar i Kuvendit Komunal të Mamushës, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-2426/13 dhe 03-2427/13, për zyrtarin e lartë z. Halim Sadiku – Anëtar i Kuvendit Komunal të Mamushës, dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat “D.P.T. Ideali” dhe person i autorizuar në biznesin privat “D.P.T. Universal – H”, është trajtuar sipas procedurës së parapare në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Sadiku, fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është takuar me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar mënyra se si duhet parandaluar dhe shmangur konfliktin e interesit. Në këtë takim ai ka konfirmuar se në cilësinë e zyrtarit të lartë ushtron funksionin e Anëtarit të Kuvendit Komunal të Mamushës dhe është pronar në biznesin privat “D.P.T. Ideali” dhe person i autorizuar në biznesin privat “D.P.T. Universal – H”.

Mirëpo, përkundër afatit ligjor të dhënë nga Agjencia, zyrtari i lartë nuk ka ndërmarr asnjë veprim që të parandaloj dhe të shmangë këtë situatë, prandaj atij i është dërguar shkresa e dytë (njoftimi paralajmërues), me të cilën nga zyrtari i lartë është kërkuar që brenda afatit të paraparë ligjor të ndryshoj këtë gjendje.

Pas pranimit të shkresës së dytë, z. Sadiku, ka kontaktuar zyrtarët e Agjencisë dhe ka premtuar se brenda një afati të shkurtër kohor do të bëj ndryshimet e kërkuara.

Ndërkohë, z. Sadiku, ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 806/14 dhe 03 - 807/14) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka autorizuar një person të besueshëm për të udhëhequr bizneset private.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

